



Prishtinë, 30.11.2012
Kodi i ZRRE-së: V_485_2012

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) të dhëna me Nenin 14 pika 2.6 dhe Nenin 43, të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr.03/L-185;
- Dispozitat e Nenit 17 të Ligjit për Energjinë Nr. 03/L-184; dhe
- Shkresën / Njoftimin e Ngrohtores së Qytetit (NQ) Gjakova SH.A. të datës 30 nëntor 2012 lidhur me vendimin e tyre për të mos aplikuar për ngritjen e tarifave.

Në seancën e mbajtur me datë 30 nëntor 2012, nxori këtë:

VENDIM

- I. APROVOHEN** tarifat e ngrohjes qendrore për Ngrohtoren e Qytetit (NQ) Gjakova SH.A. për sezonin e ngrohjes 2012/2013, siç janë paraqitur në tabelat "A" dhe "B".

Arsyetim

- Me datën 30 nëntor 2012, Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka pranuar shkresën nga Ngrohtorja e Qytetit (NQ) Gjakova SH. A, me anë të së cilës ZRRE njoftohet se, menaxhmenti i NQ Gjakova, në koordinim me Bordin e drejtorëve, ka marrë vendim që të mos aplikoj për ngritjen e tarifave për sezonin 2012/2013. Në këtë njoftim gjithashtu theksohen edhe arsyet për një vendim të tillë:
 - Rikthimi i besimit të konsumatorëve, i cili është cenuar gjatë sezonit të kaluar kur NQ Gjakova ka dështuar që t'ju siguroj konsumatorëve furnizim të qëndrueshëm dhe kualitativ;
 - Rritja e tarifave në këtë situatë do të ndikonte negativisht në arkëtimin e pagesave nga konsumatorët – përkundrazi, është vlerësuar se zbatimi i tarifave ekzistuese bashkë me furnizimin e përmirësuar do të ndikojë pozitivisht në shtimin e shkallës së arkëtitimit të pagesave.
 - Për vendosjen e tarifave të ngrohjes qendrore, ZRRE ka marr parasysh arsyetimet e paraqitura në shkresën e NQ Gjakova, të cilat i ka konsideruar të drejta dhe të argumentuara.
 - Duke marr parasysh dispozitat ligjore të theksuara në hyrje dhe duke u bazuar në shqyrtimin e shkresës së NQ Gjakova të datës 30 nëntor 2012, Bordi i ZRRE-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- II.** Struktura e tarifave të Ngrohtores së Qytetit Gjakova SH. A për sezonin e ngrohjes 2012/2013 është dhënë në tabelën e mëposhtme:



TARIFAT PËR NGROHTOREN E QYTETIT GJAKOVASH.A.
PËR SEZONIN E NGROHJES 2012/2013

Tabela A. TARIFA PËR KONSUMATORËT PA MATJE

NGROHTORJA E QYTETIT GJAKOVA SH.A.		
Komponentet e Tarifave	Konsumatorët shtëpiakë	Konsumatorët Komerเชียลë e Institucionalë
Tarifa për kapacitetin e kontraktuar të ngrohjes (komponenta fikse)	0.09 [€/m ² për muaj]	0.12 [€/m ² për muaj]
Tarifa për ngrohjen e furnizuar (komponenta variabile)	0.88 [€/m ² për muaj]	1.27 [€/m ² për muaj]

Tabela B. TARIFA PËR KONSUMATORËT ME MATJE

NGROHTORJA E QYTETIT GJAKOVA SH.A	
Tarifa për kapacitetin e kontraktuar të ngrohjes (komponenta fikse)	0.91 [€/kW për muaj]
Tarifa për ngrohjen e furnizuar (komponenta variabile)	58.76 [€/MWh]

- III. NQ Gjakova SH. A duhet ta publikoj këtë vendim, brenda pesë (5) ditëve të punës pas marrjes së vendimit dhe publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, në së paku një prej gazetave ditore me qarkullim të gjerë në Kosovë,.
- IV. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka të drejtë që të auditoj regjistrat e kontabilitetit dhe faturat e NQ Gjakova SH.A. për të verifikuar realizimin e të Ardhurave dhe Kostove në sezonin 2012/2013.
- V. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
- VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente, brenda katërbëdhjetë (14) ditëve, nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, Kryesues

Përparim Kabashi, Anëtar

Blerim Koci, Anëtar

Merita Kostari, Anëtare

Krenar Bujupi, Anëtar